

KUPTIMI I  
BASHKIMIT  
EVROPIAN

Zgjerimi drejt  
një të ardhmeje  
të qëndrueshme  
dhe të pasur me  
vende pune



# Evropa 2020: Strategjia Evropiane e Zgjerimit

‘Kontributi i BE-së duhet të jetë një hap i madh drejt një Bashkimi të stabilitetit dhe drejt një zgjerimi gjithmonë e më të afërt dhe më të fuqishëm.’

Kryetari i Komisionit Evropian  
Barroso, Qershor 2012

## KUPTIMI I BASHKIMIT EVROPIAN

Ky botim është pjesë e botimeve që sqarojnë se çfarë bën BE-ja në fusha të politikave të ndryshme, si përfshihet në to dhe cilat janë rezultatet. Për t'i parë dhe shkarkuar botimet që janë në dispozicion shkoni tek: [http://europa.eu/pol/index\\_en.htm](http://europa.eu/pol/index_en.htm)

Si funksionon BE-ja  
Evropa 2020: Strategjia evropiane e zgjerimit ✕  
Themeluesit e BE-së

Bujqësia  
Kufijtë dhe siguria  
Buxheti  
Veprimet klimatike  
Konkurrenca  
Konsumatorët  
Kultura  
Doganat  
Zhvillimi dhe bashkëpunimi  
Agejnda digjitale  
Bashkimi ekonomik dhe monetar dhe Euroja  
Arsimi, trajnimi, rinia dhe sporti  
Punësimi dhe çështjet sociale  
Energjia  
Zgjerimi  
Sipërmarrësia  
Mjedisi  
Lufta kundër mashtrimit  
Peshkimi dhe çështjet detare  
Siguria në ushqim  
Çështjet e jashtme dhe politikat e sigurisë  
Ndihma humanitare  
Tregu i brendshëm  
Drejtesia, shtetësia, të drejtat themelore  
Migracioni dhe azili  
Shëndeti publik  
Politika rajonale  
Hulumtimi dhe inovacioni  
Tatimi  
Tregtia  
Transporti

### PËRMBAJTJA

Pse kemi nevojë për strategjinë e zgjerimit Evropa 2020 Reforma për konkurrencë më të madhe .....	3
Qasja e BE-së Udhëheqja dhe mbështetja financiare .....	6
Si vepron BE-ja Iniciativat e synuara .....	9
Vështrime Krijimi i vendeve të punës dhe rritja përfshirëse .....	12
Tekste plotësuese .....	12

#### Kuptimi i Bashkimit Evropian:

#### Evropa 2020: Strategjia evropiane e zgjerimit

Komisioni Evropian  
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim  
Publikime  
1049 Bruksel  
BELGJIKË  
Dorëshkrimi i mbaruar në dhjetor 2012  
Fotografia e kopertinës dhe faqes 1: © Phovoir  
2012 — 12 pp. — 21 × 29.7 cm  
ISBN 978-92-9238-107-3  
doi:10.2871/52265  
Luksemburg: Zyra e Bashkimit Evropian për Botime, 2013  
© Bashkimi Evropian, 2013  
Riprodhimi është i autorizuar. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive individuale duhet të kërkohet leje drejtpërdrejt nga mbajtësit e të drejtave të autorit.

## Pse kemi nevojë për strategjinë evropiane të zgjerimit Evropa 2020

### Reforma për konkurrencë më të madhe

Ashtu si shumë rajone rreth botës, edhe Evropa është duke kaluar në një fazë transformimi. Kriza ekonomike globale ka zhdukur vite të tëra të përparimit ekonomik dhe social dhe ka nxjerrë në dukje dobësitë strukturore në ekonominë e saj. Ndërkaq, sfidat e ndryshme afatgjate siç janë globalizimi, shtypja që u bëhet burimeve natyrore dhe plakja e popullsisë janë në rritje e sipër. Nëse duam të adaptohem me këtë realitet që po ndryshon, Evropa nuk mund të gjejë mbështetjen e zakonshme në biznes.

Dobësitë strukturore në ekonominë e Evropës që kanë dalë në pah nga kriza, mund të trajtohen duke shkuar përpara me reforma strukturore: reforma që bazohen në përpjekje nacionale por që ndërtojnë pasuri të përbashkëta evropiane siç janë tregu i vetëm, politika e përbashkët për tregti dhe politika të tjera në nivel të BE-së. Nëse duam ta mbajmë modelin evropian të ekonomisë sociale të tregut në klimën e tanishme sfiduese, atëherë Evropa duhet të bëhet më konkurruese.

Për të trajtuar këto çështje, Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij në vitin 2010 kanë filluar një strategji për zgjerim të qëndrueshëm gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm: strategjinë Evropa 2020. Kjo strategji trajton sfidat afatshkurtra që lidhen me krizën si dhe nevojën për reforma strukturore përmes masave që nxisin zgjerimin e nevojshëm, për të bërë ekonominë e Evropës të përshtatshme për të ardhmen.

*Politikat e BE-së synojnë të punësojnë 75 % të popullsisë aktive deri në vitin 2020.*



#### Qëllimet dhe iniciativat kryesore

BE-ja ka vendosur pesë qëllime ambicioze për punësim, inovacion, arsimim, përfshirje sociale dhe klimë/energji — që duhet të plotësohen deri në vitin 2020. Në terme më konkrete ato janë:

1. Sigurimi i një punësimi prej 75% për personat e moshës 20–64 vjeçare;
2. Investimi 3% nga BPV i BE-së për hulumtim dhe zhvillim;
3. Kufizimi i emetimeve të gazit serrë deri për 20 % ose edhe për 30 % në krahasim me nivelet e vitit 1990, duke prodhuar 20 % të nevojave për energji nga energjia e ripërtëritshme dhe rritjen e efikasitetit të energjisë për 20 %;
4. Ulja e shkallës së braktisjes së shkollimit deri në më pak se 10 %, me të paktën 40 % të personave të moshës 30–34 vjeçare me shkollim të lartë;
5. Sigurimi se 20 milionë njerëz më pak janë në rrezik nga varfëria ose përjashtimi social.

Çdo shtet i BE-së ka miratuar qëllimet e veta nacionale në secilën nga këto fusha, dhe udhëheqësit e BE-së kanë rënë dakord për një numër të aksioneve konkrete në nivel të BE-së dhe në nivele nacionale. Gjithashtu shtetet kanë identifikuar fushat më të rëndësishme të veprimit që besojnë se mund të jenë motorët që do të nxisin zgjerimin dhe krijimin e vendeve të punës. Këto fusha trajtohen përmes shtatë 'iniciativave kryesore'.

- 'Njësia për Inovacion': ka për qëllim përmirësimin e kushteve dhe qasjen deri tek mjetet financiare për hulumtim dhe inovacion, ashtu që idetë inovative të mund të shndërrohen në prodhime dhe shërbime dhe kështu të krijohet zgjerim dhe vende pune.
- 'Rinia në lëvizje': ka për qëllim të shtojë ecurinë e sistemeve arsimore dhe të lehtësojë kyçjen e të rinjve në tregun e punës. Kjo bëhet, ndër të tjera, përmes studimeve të financuara nga BE-ja, përmes programeve për mësim dhe trajnim, si dhe përmes platformave që i ndihmojnë të rinjtë e papunë për të gjetur punë rreth BE-së.

- ‘Agjenda digjitale për Evropën’: ka për qëllim përshtetimin e internetit me shpejtësi të lartë dhe përmirësimin e informimit dhe teknologjive të komunikimit.
- ‘Evropa me burime të pasura natyrore’: ka për qëllim të ndihmojë ndarjen e rritjes ekonomike përmes përdorimit të burimeve natyrore. Ajo mbështet shtrirjen drejt një ekonomie me sasi të ulët të karbonit, rritjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, zhvillimin e teknologjisë së gjelbërt dhe modernizimit të sektorit të transportit, dhe promovon efikasitetin e energjisë.
- ‘Politika industriale për epokën e globalizimit’: ka për qëllim përmirësimin e hapësirës së biznesit kryesisht për NVM-të, për shembull duke u ndihmuar atyre të kenë mundësi kreditimi dhe zvogëlimi i burokracisë. Ajo gjithashtu mbështet zhvillimin e një baze të fortë dhe të qëndrueshme industriale që mund të jetë inovative dhe konkurrense në nivel botëror.
- ‘Agjenda për aftësi dhe vende të reja pune’: ka për qëllim modernizimin e tregjeve të punës dhe fuqizimin e njerëzve duke zhvilluar aftësitë e tyre dhe duke përmirësuar fleksibilitetin dhe sigurinë e tyre në hapësirën e punës. Ajo gjithashtu duhet të ndihmojë punëtorët që më lehtë të kërkojnë punë rreth BE-së duke bërë përshtatje të kërkesës dhe ofertës për punë.


- ‘Platforma evropiane kundër varfërisë’: ka për qëllim sigurimin e reciprocitetit social dhe territorial duke ndihmuar të varfërit dhe personat e përjashtuar nga shoqëria të kenë qasje në tregun e punës dhe të jenë anëtarë aktivë të shoqërisë.
- Gjithashtu, janë duke u shfrytëzuar edhe politika dhe aktivitetet e tjera të BE-së për të mbështetur strategjinë Evropa 2020, si për shembull tregu i vetëm, buxheti i BE-së (që shfrytëzohet në mënyrë strategjike për të mbështetur fushat kyçe të strategjisë Evropa 2020) dhe politika e BE-së për tregti (e cila, për shembull, promovon lidhje më të fuqishme tregtare që mund t’u sjellin ndërmarrjeve evropiane qasje deri tek prokurimet qeveritare dhe programet hulumtuese tek shtetet e treta).



Interneti me shpejtësi të lartë duhet të jetë në dispozicion në mbarë Evropën


Synimet e Evropës për 2020

RRITJA E PUNËSIMIT DERI NË 75 %




Numri i personave të moshës 20-64 vjeçare që janë të punësuar

PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT TË ENERGJISË PËR 20 %




Konsumimi i energjisë primare ekuivalent me një milion ton naftë

INVESTIMI I 3 % TË BPV PËR HULUMTIM DHE ZHVILLIM




ZVOGËLIMI I SHKALLËS SË BRAKTISJES SË SHKOLLIMIT DERI NË MË PAK SE 10 %




Numri i personave të moshës 18-34 vjeçare me jo më shumë se shkollim të ulët ose të mesëm dhe jo në arsimim dhe trajnim

ULJA E EMETIMIT TË GAZIT SERË PËR 20 % NË KRAHASIM ME 1990




Treguesi për emetimet në 1990 = 100

TË NUMRIT TË PERSONAVE TË MOSHËS 30-34 VJEÇARE MË SHKOLLIM TË LARTE NË MË PAK SE 40%



Numri i personave të moshës 30-34 vjeçare që kanë përfunduar me sukses studimet universitare ose shkollim të barabartë me atë universitarin

RRITJA E SASIË SË ENERGJISË SË RIPËRTERITSHME DERI NË 20 %



Sasia e energjisë së ripërtëritshme në konsumimin bruto të energjisë

Të gjitha grafet tregojnë shifrat për 27 shtete të BE-së në 2005 dhe 2010, si dhe qëllimet për 2020 për të cilat është rënë dakord në kuadër të strategjisë Evropa 2020. Synimi për ulje të varfërisë duke larguar të paktën 20 milionë njerëz nga rreziku i varfërisë dhe rreziku i përjashtimit social nuk matet siç maten synimet e tjera, për shkak të mungesës së statistikave për krahasim. Në këtë kategori në vitin 2010 llogariten të kenë rënë 115 milionë qytetarë të BE-së.

Burimi: Komisioni Evropian.

# Qasja e BE-së

## Udhëheqja dhe mbështetja financiare

Kriza na ka dëshmuar se sa të ndërlidhura janë ekonomitë tona. Një vendstrehim nga një shtet mund të ndikojë në shtetet fqinje si dhe në gjithë Unionin. Kjo varshmëri e rritur ekonomike kërkon një përgjigje të koordinuar, duke përfshirë partnerët socialë dhe shoqërinë civile. Nëse veprimet të bashkuar mund të dalin nga kriza së bashku. Në një botë të globalizuar, asnjë shtet nuk mund të ballafaqohet me sfidat që i dalin përpara duke vepruar i vetëm. Kjo është në veçanti e vertetë për Evropën, ku trajtimi i sfidave të tilla është shumë efektiv në nivel të BE-së.

Nxitja e zgjerimit dhe konkurrencës së ekonomive evropiane ka qënë përqëndrimi kryesor i punës së Komisionit Evropian që nga fillimi i krizës. Për të arritur këtë, financat publike duhet të vendosen në një pozitë më të sigurt dhe më stabile dhe sektori përgjegjës financiar duhet të jetë në shërbim të ekonomisë së vërtetë. Gjithashtu, duhet udhëheqje më e fuqishme ekonomike dhe diciplinë dhe Shtetet Anëtare duhet të vazhdojnë mundin e tyre për të bërë reforma fundamentale strukturore për të nxitur konkurrencën. Nëse duam që kjo të funksionojë, gjithçka duhet të zhvillohet paralelisht.

### Udhëheqje e fuqishme e politikave ekonomike nacionale

Semestri Evropian është ajo periudhë vjetore kur Shtetet Anëtare koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe punojnë për zbatimin e strategjisë Evropë 2020. Semestri Evropian siguron që shtetet e BE-së të informojnë publikisht për planet e politikave të tyre të punësimit, makroekonomike dhe strukturore, ashtu që të mund të mësojnë nga njëri tjetri dhe të zbulojnë problemet paraprakisht.

Qëllimi i Semestrit Evropian është përfundimi i koordinimit mes politikave ekonomike të Shteteve Anëtare derisa ato janë akoma në përpunim, ashtu që të zbulohen mospërputhjet e mundshme. Kjo paraqet një ushtrim sistematik dhe të plotë të monitorimit të ekonomisë evropiane.

Komisioni fillon semestrin evropian çdo vjet me paraqitjen e raportit të quajtur 'Anketa vjetore e zhvillimit' në Parlamentin dhe Këshillin Evropian. Ky raport është themel për diskutimet nga udhëheqësit e BE-së — Kryetarët e Shteteve ose Qeverive të Shteteve Anëtare të BE-së — që takohen në Këshillin Evropian në mars (ky quhet Këshilli pranveror) për të ofruar një udhëzim të përgjithshëm për strategjinë Evropë 2020.

Në bazë të këtij udhëzimi, çdo Shtet Anëtar i BE-së duhet të hartojë dy programe: programin e reformave nacionale dhe programin e stabilitetit ose konvergencës. I pari trajton arritjen e progresit sa i përket standardeve të strategjisë Evropë 2020 dhe cilat janë hapat që do të ndërmerren gjatë vitit të ardhshëm për të trajtuar mangësitë e mbetura. I dyti trajton planet buxhetore shumëvjeçare. Pastaj, këto dy dokumente dërgohen deri tek Komisioni Evropian për tu vlerësuar në prill.

Mbi këtë bazë, Komisioni nxjerr rekomandime të veçanta për çdo shtet, të cilat pastaj miratohen nga Këshilli Evropian në qershor. Këto rekomandime mbulojnë një sërë çështjesh duke përfshirë gjendjen e financave publike, aftësinë e sektorit bankar për mbajtjen e ekonomisë, reformat pensionale, sfidat e zgjerimit dhe konkurrencës, krijimin e vendeve të punës dhe masave për arsimim, pasqyrimin e prioritetëve të vendosura në anketën vjetore të zgjerimit.

Përderisa programet e reformave nacionale dhe programet e stabilitetit ose konvergencës përgatiten nga Shtetet Anëtare si dhe në bazë të konsultimeve me palët nacionale, rekomandimet e veçanta për çdo shtet përgatiten nga Komisioni Evropian për çdo Shtet Anëtar veç e veç. Këto rekomandime me qëllime të caktuara dhe konkrete, të cilat shtetet duhet t'i plotësojnë gjatë 12-18 muajve në vazhdim, bazohen në analizat e programeve të ofruara nga Shtetet Anëtare dhe të plotësuara nga takimet bilaterale mes ekspertëve nga Komisioni dhe Shtetet Anëtare.

## Shmangia e deficiteve dhe rritja e diciplinës fiskale

Kriza financiare ka sjellur në dukje një numër të dobësive të qeverisjes së BE-së me bashkësinë monetare dhe ekonomike. Gurthemeli i përgjigjes së BE-së është grupi i ri i rregullave për përfundim të qeverisjes ekonomike që hyri në fuqi në 2011. Zbatohen edhe disa rregulla shtesë të veçanta për shtetet e zonës së Euros.


Këto rregulla më të rrepta përfshijnë sanksione për Shtetet Anëtare që nuk kryejnë përgjegjësitë e tyre për kthimin e buxheteve në një situatë të qëndrueshme. Në rast të deficitit të tepërt, do të vendosen sanksione financiare — që vlejnë vetëm për shtetet e zonës së Euros – në mënyrë graduale, dhe do të arrijnë 0.5 % nga BPV.

Gjithashtu, 25 Shtete Anëtare të BE-së (17 shtete të Eurozonës dhe tetë të tjera) kanë rënë dakord për një marrëveshje të re ndërqeveritare, të njohur si Kompakti Fiskal, për të rritur konvergencën dhe diciplinën fiskale. Kjo është një deklaratë e qartë politike që shtetet e Eurozonës do të marrin çdo masë të nevojshme për të mbështetur Euron.

## Kujdesi nga çekuilibret makroekonomike

Si pjesë e këtij grupi të ri të rregullave, është formuar një mekanizëm për vëzhgim dhe zbatim për të identifikuar dhe përmirësuar mangësitë serioze në konkurrencë: kjo quhet Procedura e Çekuilibrit Makroekonomik (MIP). Kjo procedurë ka për qëllim identifikimin e çekuilibreve të ekonomive të Shteteve Anëtare shumë më herët se më parë. Ajo monitoron ekonomitë nacionale në mënyrë të detajuar dhe sinjalizon paraprakisht institucionet e BE-së për problemet potenciale.

MIP shfrytëzon një tabelë që ndjek ndryshimet në 11 tregues ekonomik, siç janë aksionet e tregut, kostot e fuqisë së punës, borxhi i sektorit privat dhe çmimet e shtëpive. Aty ku vërehen çekuilibre – për shembull, rritje e rrogës që nuk është në përputhje me linjën e rritjes së prodhimit, ose rritje e shpejtë e çmimeve të shtëpive — çohen rekomandime deri tek Shtetet Anëtare në fjalë, dhe mund të kërkohet një plan me pikarritje të qarta për të 'ekuilibruar' ekonominë. Në fundmi, mund të zbatohen sanksione financiare për shtetin e Eurozonës nëse nuk ndërmerren masa korigjuese.



## Stabiliteti financiar

Kriza ka vënë në dyshim besimin tek Eurozona, gjë që ka marrë një përgjigje të përcaktuar. Është bërë përforsimi i barrierave dhe mjeteve mbrojtëse për të ndihmuar shtetet e Eurozonës që kanë vështirësi. Mekanizmi Evropian për Stabilitet (ESM), me 700 miliardë euro, do të ketë më shumë kapital nga çdo organizatë tjetër në botë dhe do të jetë në gjendje të kreditojë 500 miliardë euro nga borxhet. ESM filloi të funksionojë në shtator 2012. Ai zëvendëson dy mekanizmat e mëparshëm të përkohshëm, Paktin Evropian për Stabilitet Financiar (EFSF) dhe Mekanizmin Stabilizues Financiar Evropian (EFSM).

Kapaciteti i likuiditetit dhe kreditimit të bankave është përforsuar në afat të shurtër, si dhe është përforsuar dukshëm rregullat dhe mbikqyrja e sektorit financiar të BE-së për të shmangur problemet e ngjashme në të ardhmen.

## Zgjerimi dhe krijimi i vendeve të punës

Të gjitha masat e përmendura më lartë kanë për qëllim kryesor krijimin e një ambienti që favorizon zgjerimin dhe krijimin e vendeve të punës në BE, sepse kjo është mënyra e vetme për të vazhduar të financojmë mënyrën tonë të jetesës. Që nga fillimi i krizës, Komisioni ka bërë thirrje të vazhdueshme për masa që nxisin zgjerimin, që janë në qendër të strategjisë Evropa 2020. Sidoqoftë, ky zgjerim duhet të ketë themele të sigurta; kjo është arsyeja se pse Komisioni është duke vepruar për promovimin e një zgjerimi të zgjuar, të qëndrueshëm dhe përfshirës.

Këshilli Evropian ka rënë dakord për një Marrëveshje për Zgjerim dhe Vende të punës që mes të tjerash do të sjellë më shumë kapital në ekonominë evropiane përmes një kapaciteti më të madh të kreditimit nga Banka Investuese Evropiane, dhe do të bëjë thellim të tregut të vetëm evropian.

*Njëzet përqind e energjisë së Evropës duhet të vijë nga burime të ripërtëritshme deri në 2020.*



## Financimi i strategjisë Evropa 2020

Çdo veprim i Bashkimit Evropian mbështetet nga buxheti i vet, i cili tani është i përqëndruar më shumë se kurrë në zgjerimin ekonomik. Kjo vlen edhe për propozimin e buxhetit shumëvjeçar të BE-së për vitet 2014–20. Në veçanti, Fondet Strukturore të BE-së, që u janë shpërndarë Shteteve Anëtare, ofrojnë mbështetje për reformat dhe për krijimet e vendeve të punës.

Buxheti i BE-së është i drejtuar kah investimet në të gjitha Shtetet Anëtare për sfida të përbashkëta, siç janë nxitja e zgjerimit, krijimi i vendeve të punës në mbarë Evropën dhe rritja e ndikimit që Evropa ka në botë. Buxheti i BE-së nuk kërkon të financojë atë që mund të financohet nga buxhetet nacionale, por përqëndrohet aty ku financimi evropian sjell vlerë të vërtetë. Ai financon atë që nuk do të ishte financiar ose atë që do të ishte më e shtrenjtë për financim nga buxhetet nacionale.

## Përfshirja e gjerë

Parlamenti Evropian luan një rol të rëndësishëm në mobilizimin e parlamenteve nacionale për të luajtur rolin e tyre. Me rregullat e reja për qeverisje ekonomike, Parlamenti Evropian mund të vendosë dialog ekonomik me Këshillin dhe Komisionin. Në esencë, kjo domethënë që Parlamenti mund të shqyrtojë dhe kërkojë përgjigje nga të dy institucionet rreth propozimeve dhe vendimeve të tyre. Kjo bën që procesi të jetë më transparent dhe Këshilli dhe Komisioni më të përgjegjshëm.

Të gjitha pjesët e shoqërisë duhet të përfshihen në strategjinë Evropa 2020. Kjo duhet të kalojë në qendër të shoqërisë, duke përfshirë këtu bizneset, sindikatat, OJQ-të dhe qytetarët si individë. Për të ndihmuar arritjen e kësaj Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social ka formuar një komitet drejtues për strategjinë Evropa 2020, me rrjete të gjera në gjithë Evropën. Në këtë linjë, Komiteti i Rajoneve ka formuar Platformën Monitoruese Evropa 2020 që përfshin autoritete rajonale dhe lokale. Që të dy komitetet paraqesin opinione që kontribuojnë në diskutimin gjatë Këshillit Evropian pranveror. Në të vërtetë, një pjesë e madhe e strategjisë zbatohet në nivele lokale dhe rajonale të shteteve të BE-së. Kjo përfshin autoritete lokale dhe rajonale, partnerë social dhe shoqëri të civilë.

## Si vepron BE-ja

### Iniciativat e synuara

Arritja e synimeve të strategjisë Evropa 2020 mund të rrisë potencialin për zgjerim ekonomik në shtetet e BE-së. Qëllimi i këtyre synimeve është të sjellin një hap të përshtatshëm për çdo Shtet Anëtar të BE-së duke bërë gjithçka që është e mundur për të pasur progres në fushat kyçe.

Evropa ka punuar më së miri kur ka punuar e bashkuar, dhe ekziston një numër i madh i arritjeve që Evropa mund të numërojë si shembull të arritjeve të përbashkëta. Airbus është krijuar në vitet e 70-ta mes katër shteteve evropiane, dhe sot mund të mburret me një fuqi pune prej mbi 50 000 të punësuarish si një nga prodhuesit kryesorë të aeroplanëve në botë.

Galileo është sistemi i navigacionit satelitor të Evropës dhe mund të ofrojë më shumë saktësi se GPS-i i SHBA-ve ose sistemi Glonass i Rusisë. Ai duhet të fillojë funksionimin në 2019 pasi të jenë lëshuar të gjithë satelitet.

Banka Evropiane e Investimeve (EIB) para pak kohësh ka ndihmuar financimin e mullinjve me erë më të mëdhenj në botë. Mullinjtë me erë Thanet dhe Walney në Britaninë e Madhe mund të prodhojnë mbi 600 MW, që mund të furnizojnë 500 000 shtëpi të atjeshme, duke rritur potencialin e energjisë së ripërtëritshme të BE-së.

Këto dhe projekte të tjera janë bërë të mundura përmes një bashkëpunimi të afërt evropian në të gjitha sektorët, dhe projekte të tilla të mëtutjeshme mund të realizohen në kuadër të iniciativave kryesore të strategjisë Evropa 2020.

### Arritjet kryesore

Zbatimi i iniciativave kryesore të strategjisë Evropa 2020 tashmë është në zhvillim e sipër. Në përgjithësi, përparimi ka qënë i kënaqshëm. Brenda çdo iniciative kryesore janë përfunduar një numër i aksioneve kyçe. Disa shembuj jepen më poshtë.

### Evropa 2020 për të rinjtë

Çdo vit, 6 milionë evropianë të rinj përfundojnë shkollimin me arsimim të mesëm. Sot kjo përfaqëson 14 % nga personat e moshës 18–24 vjeçare, gjë që nxit nivelin e lartë të papunësisë tek të rinjtë.

Kjo është arsyeja se pse Komisioni Evropian mundohet të rrisë numrin e të diplomuarve, të përmirësojë cilësinë e

mësimdhënies dhe të sjellë deri në maksimum atë që arsimi i lartë mund të bëjë për të ndihmuar ekonominë e BE-së për të dalë më të fuqishëm nga kriza. Strategjia e tij identifikon fushat kyçe ku shtetet e BE-së duhet të veprojnë më shumë për të arritur qëllimet e përbashkëta për arsim dhe përcakton se si BE-ja mund të mbështesë politikat e tyre të modernizimit. Iniciativat në nivel të BE-së përfshijnë një radhë shumëdimensionale universitare që do të ndihmojë informimin e studentëve rreth drejtimeve që do t'u përshtaten më mirë.

Programi për këmbim të studentëve Erasmus që nga fillimi i tij më 1987 ka bashkëfinancuar 3 milionë bursa. Komisioni ka propozuar një program të ri — 'Erasmus për të gjithë'. Ky program do të bëjë të mundur që 5 milionë njerëz të marrin bursa nga BE-ja për studim, trajnim ose punë vullnetare jashtë shtetit mes 2014 dhe 2020, që është afërsisht dyfishi i atyre që janë tani. Gjithashtu, do të ekzistojë edhe skema e garancisë për kredi 'Erasmus për Master' për studentët që ndjekin shkollim të plotë në studimet master në një shtet tjetër të BE-së.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe disa iniciativa të posaçme që bëjnë lidhjen e të rinjve me vendet e lira të punës, përderisa fushatat për rritje të vetëdijes kanë për qëllim të inkurajojnë kërkesën për punësim të të rinjve dhe lehtësim të kontaktit me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Përveç kësaj, Komisioni ka propozuar që Shtetet Anëtare dhe BE-ja të gjejnë përdorim më të mirë të Fondit Social Evropian (ESF) për të trajtuar papunësinë e të rinjve. Kjo do të arrihet fillimisht duke mbështetur tranzicionin nga shkolla në punë dhe duke mbështetur mobilitetin e tregut të punës të të rinjve.

*Është mirë për ekonominë kur më shumë njerëz udhëtojnë për të mësuar ose punuar në shtete të tjera të BE-së.*



## Në praktikë: Vendi yt i parë i punës EURES

Programi 'Vendi yt i parë i punës EURES' ka për qëllim të ndihmojë njerëzit të gjejnë vende pune në BE. Ai bazohet në mbështetjen nga shërbimet nacionale për punësim — informata, kërkim të punës, punësim dhe financim — për të rinjtë që kërkojnë punë si dhe për bizneset që interesohen për të punësuar persona nga jashtë. Ky program ndihmon ata që kërkojnë punë duke bërë lidhjen me vendet e punës dhe duke mbështetur dhe financuar vendet e punës sa i përket udhëtimit për intervistë dhe/ose shpërnguljes jashtë shtetit për të filluar një punë të re. Nga ana tjetër, punëdhënësit fitojnë mbështetje për punësim, përderisa bizneset e vogla dhe të mesme mund të fitojnë mbështetje financiare për të mbuluar një pjesë të çmimit të trajnimit të punëtorëve të rinj dhe për të ndihmuar ata të adaptohen.

## Evropa 2020 dhe lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit social

Me më shumë se 80 milionë njerëz në BE të rrezikuar nga varfëria — duke përfshirë këtu 20 milionë fëmijë dhe 8 % të popullsisë aktive — Platforma Evropiane kundër Varfërisë dhe Përjashtimit Social ka përcaktuar veprime për të arritur qëllimin e BE-së për zvogëlim të varfërisë dhe përjashtimit social për së paku 20 milionë deri në 2020. Edhe pse lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit social është kryesisht përgjegjësi e qeverive nacionale, BE-ja mund të luajë një rol udhëheqës duke identifikuar praktikat më të mira dhe duke promovuar mësimin e përbashkët, me vendosjen e rregullave të gjera të BE-së dhe me sigurimin e fondeve. Veprimet kyçe për të arritur këtë janë qasja më e madhe drejt punës; siguria sociale; arsimimi; dhe shërbimet thelbësore siç janë shëndetësia dhe banimi. Veprimet e tjera kyçe përfshijnë përdorim më të mirë të fondeve të BE-së për mbështetje të përfshirjes sociale dhe luftës kundër diskriminimit; inovacionet shoqërore për gjetje të zgjidhjeve 'të zgjuara'; dhe partneritete të reja mes sektorit publik dhe atij privat.

## Evropa 2020 dhe inovacioni

Iniciativa kryesore 'Unioni Inovativ' ka për qëllim krijimin e lidhjeve mes hulumtimit dhe inovacionit dhe krijimit të vendeve të punës, që është diçka thelbësore nëse Evropa

dëshiron të dalë nga kriza e tanishme ekonomike. Çdo Euro e investuar në BE sjell rritje të vlerës së shtuar industriale me shumë mes 7 euro dhe 14 euro, përderisa shpenzimi i 3% të BPV të BE-së për hulumtim dhe zhvillim deri në vitin 2020 do të mund të krijonte 3.7 milionë vende pune dhe rritje të BPV vjetor për afër 800 miliardë € deri në 2025.

Komisioni ka bërë nisjen e një platforme për të mbështetur rajonet dhe Shtetet Anëtare për të definuar më mirë strategjitë e tyre për hulumtim dhe inovacion. Pasi nuk ekziston një linjë veprimi për politikë të njëtrajtshme, kjo platformë do të ndihmojë rajonet të vlerësojnë përparësitë dhe mangësitë e hulumtimeve dhe inovacioneve të tyre të veçanta dhe të ndërtojnë përparësi konkurruese.

Në 2012 është rënë dakord për një patent të BE-së që do të kursejë deri në 80% të çmimit të patentës të kompanive dhe zbuluesve. Kandidatët për patentë do të mund të marrin një patentë të vetme evropiane në vend të aplikimit për një të tillë në çdo shtet të BE-së. Kjo do të vlejë për 25 Shtetet Anëtare të BE-së që kanë rënë dakord me këtë propozim, sipas procedurës së bashkëpunimit të zgjeruar. Më pare duhej të kërkohej mbrojtje e patentës në çdo shtet të BE-së dhe kjo mund të kushtonte deri në 36 000 euro. Sipas marrëveshjes për patentën kjo vlerë mund të ulet deri në 680 euro në plan afatgjatë.

Komisioni Evropian dhe Grupi Bankar Investues Evropian kanë miratuar një marrëveshje të re garantuese për të ndihmuar NVM-të inovative të kenë qasje tek fondet bankare. Pritet që të zhblokohen edhe 6 miliardë euro të kredive të tjera deri në fund të 2013, që përfshijnë deri në 1.2 miliardë euro për NVM-të dhe deri në 300 milionë euro për infrastrukturë të hulumtimit.

*Financimi i BE-së përmirëson kushtet për hulumtim dhe inovacion*

© iStockphoto.com



## Në praktikë: Zgjidhje inovative

'Plakja aktive dhe e shëndetshme' ka filluar në 2012 si një projekt pilot që do të startojë një sërë partneritetesh evropiane për inovacion. Këto partneritete kanë për qëllim mobilizimin e palëve të sektorit të inovacionit rreth një qëllimi të përbashkët (në këtë rast plakja e shëndetshme) për të përshpejtuar zgjidhjet inovative për sfidat shoqërore. Janë krijuar edhe partneritete të tjera për inovacion duke përfshirë partneritetin 'Efikasiteti i ujit' dhe partneritetin 'Qytete të zgjuara'.

## Një Evropë digjitale

Agjenda digjitale trajton aspektet thelbësore të ekonomisë bashkëkohore si për shembull qasjen deri tek interneti me shpejtësi të madhe dhe përmbajtjen digjitale, sigurinë në internet, shërbimet qeverisëse elektronike më efikase dhe shërbimet e reja shëndetësore që do lehtësojnë jetën e qytetarit. Ajo gjithashtu përfshin edhe sigurimin që të gjithë kanë mundësinë të përfitojnë nga revolucioni teknologjik. Partneriteti publik-privat i Internetit të së Ardhmes' (FI-PPP) është një program i BE-së për hulumtim dhe inovacion që ka për qëllim të çojë përpara konkurrencën e Evropës në teknologjitë dhe sistemet e të ardhmes së internetit duke mbështetur shërbimet dhe aplikacionet smart. Gjithashtu ky partneritet do të ndihmojë bizneset dhe qeveritë të hartojnë zgjidhje të reja të Internetit të bazuara në të dhëna komplekse onlajn për të rritur nivelin e infrastrukturës dhe proceseve të biznesit.

*Kujdesi shëndetësor në Evropë mund të bëhet më efikas përmes mënyrave digjitale të punës — për shembull kur pacientët kanë qasje të plotë tek të dhënat e tyre dhe mund të komunikojnë me mjekët nga larg.*



© iStockphoto.com

## Në praktikë: Internet më i sigurt

Një qëllim tjetër në kuadër të iniciativës kryesore Evropa Digjitale është Interneti më i sigurt për fëmijët. Kjo gjë tani është marrë përsipër nga kompani të mëdha teknologjike dhe mediatike që kanë rënë dakord ta bëjnë Internetin një vend më të sigurt për fëmijët.

## Mbështetja për efikasitet të burimeve

Iniciativa kryesore e strategjisë Evropa 2020 për një Evropë me efikasitet të burimeve, thekson nevojën për tranzicion të shpejtë drejt përdorimit të burimeve tona natyrale në mënyrë efikase. Kjo gjë do të vrente për konsumatorët dhe prodhuesit për të gjitha fushat relevante si energjia, transporti, klima, bujqësia, peshkataria dhe politika rajonale.

Komisioni Evropian propozoi rishikimin e rregullave të vjetëruara për tatimim dhe prodhimeve të energjisë në Bashkimin Evropian. Rregullat e propozuara kanë për qëllim rishikimin e mënyrës se si prodhimet e energjisë tatimohen për të hequr çekuilibrimin ekzistues dhe për të marrë parasysh edhe emetimin e CO2 edhe përbërjen e energjisë. Gjithashtu, rregullat e reja kanë për qëllim të promovojnë efikasitet të energjisë dhe konsumim të më shumë prodhimeve miqësore për mjedisin, dhe shmangie të deformimit të konkurrencës në tregun e vetëm.

## Politika industriale

Zhvillimi i shpejtë i standardeve të përbashkëta që do të sjellin kursime të çmimeve dhe përfitime si për bizneset ashtu edhe për konsumatorët është kritik për konkurrencën e Evropës. Për të arritur këtë, Komisioni propozoi një sërë masash ligjore dhe joligjore për të zhvilluar më shumë standarde në kohë më të shkurtër.

## Vështrime

### Krijimi i vendeve të punës dhe zgjerimi përfshirës

„Përveç krijimit të stabilitetit financiar, ne mundemi dhe duhet të shkojmë më tej për t'u rikthyer në rrugën e zgjerimit. Zgjerimi është çelësi, zgjerimi është përgjigja. Pra, pyetja është si mund të promovojmë zgjerimin. Dhe në fakt, unë besoj se është e rëndësishme t'ua kujtojmë njerëzve se ne kemi një strategji për zgjerim, kjo është strategjia Evropa 2020”

(Kryetari Barroso, Prill 2012)

Monitorimi i strategjisë Evropa 2020 përgjatë semestrit evropian është marrë përsipër nga Këshilli dhe Komisioni. Këtu përfshihet monitorimi i situatës së përgjithshme makroekonomike, progresi drejt pesë qëllimeve në nivel vjetor dhe progresi drejt shtatë iniciativave kryesore. Çdo vjet, në 'Anketën vjetore për zgjerim', Komisioni raporton për progresin në nivel të BE-së rreth qëllimeve dhe iniciativave kryesore të strategjisë Evropa 2020.

Tashmë janë bërë përpjekje të konsiderueshme nëpër BE dhe në disa shtete reformat janë në zhvillim e sipër. Sidoqoftë, përderisa është bërë një përparim i madh sa i përket konsolidimit fiskal, reformat për nxitje të zgjerimit mbeten akoma prapa në fushat siç janë reformat e tatimeve, reformat për pensionet dhe hapja e shërbimeve dhe sektorëve të shitjes me pakicë.

Kur strategjia Evropa 2020 do të zbatohet plotësisht, ajo do të ketë përpara një Evropë të furnizuar më mirë për të siguruar një zgjerim të zgjuar, të qëndrueshëm dhe përfshirës: një Evropë që kombinon krijimin e vendeve të punës dhe përfshirjen sociale, ku njerëzit mund të fitojnë aftësitë që u duhen për të përparuar, një Evropë që mund të përfitojë nga mundësitë globale.

## Tekste plotëuese

- Ueb faqja e Zyrës së Komisionit Evropian me të gjitha informatat rreth strategjisë Evropa 2020: [http://ec.europa.eu/europe2020/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm)

